



**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**  
**NDËRMJET**  
**AGJENCISË SHETËTËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**  
**DHE**  
**RADIOTELEVISIONIT PUBLIK TË KOSOVËS**

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e Republikës së Kosovës dhe Radio Televizioni i Kosovës shprehin vullnetin dhe gatishmërinë për të filluar bashkëpunimin e ndërsjellët në fushën e sensibilizimit të opinionit publik për sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, duke ditur se ndër misionet e këtij mediumi publik është edhe mbështetja e institucioneve shtetërore, ndihma qytetarëve për integrim, respektimi i të drejtave individuale, të jetës private, e kështu me radhë.

Nisma për këtë bashkëpunim rrjedh si nevojë e njoftimit dhe vetëdijesimit të opinionit publik rreth të drejtave të tyre në fushën e të dhënave personale dhe privatësisë, si një fushë e re në Republikën e Kosovës.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe RTK, përmes kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, parashohin realizimin e objektivave si në vijim:

- Njoftimin e opinionit publik lidhur me legjislacionin që ka të bëjë me mbrojtjen e të dhënave personale;
- Realizimin e emisioneve me karakter promovues (të Agjencisë);
- Krijimin e hapësirës së nevojshme mediale për emetimin e spoteve sensibilizuese;

Palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi janë të vetëdijshme për rëndësinë e promovimit të misionit të Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së qytetarëve, si dhe përmbushjen e misionit (mes tjerash) të RTK-së rreth mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e Republikës së Kosovës dhe Radio Televizioni i Kosovës, do të realizojnë pikat e kësaj marrëveshjeje në frymën e mirë të kësaj marrëveshjeje, në pajtim me legjislacionin përkatës, si dhe në përputhje me gatishmërinë e tyre për bashkëpunim.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e Republikës së Kosovës dhe Radio Televizioni i Kosovës dakordohen se forma dhe mënyra e bashkëpunimit do të realizohet përmes komunikimit të vazhdueshëm brenda kornizave të kësaj marrëveshjeje.

Për Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të  
Dhënave Personale

Ruzhdi Jashari

Për Radio Televizionin e Kosovës

Sylejman Shaqiri

Prishtinë, 23.05.2012